



**N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.**

**Prishtinë – Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.**

e-mail: [contact@pallatirinese.com](mailto:contact@pallatirinese.com)

www. pallatirinese.com

**Dt: 03.08.2026**

Në bazë të dispozitave të nenit 7 të Rregullores me nr 1/333 të datës 24.02.2026 për Procedurën e Dhënies me Qira të Hapësirave, dhe pas identifikimit nga Zyra për Marrëdhënie me Klient, Marketing dhe Promocion për hapësirat e lira sipas nenit 12, dhe bazuar në vendimin e datës **03.08.2026** Kryeshefi Ekzekutiv, **Shpend Bilalli** N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A., me seli në Prishtinë, me datën **03.08.2026**, mori këtë:

### FTESË PËR OFERTË

N.P.L. Pallati i Rinisë SH.A. fton të gjitha subjektet e interesuara:

- Personat juridik (për ushtrim të veprimtarisë – afarizëm),
  - Personat fizik dhe juridik (për depo),
- të aplikojnë për marrjen me qira të hapësirave për një periudhë të caktuar.  
Hapësirat e destinuara për persona juridik – hapësira afariste:

| Nr. | Adresa                                                                                                                   | Sipërfaqja            | Çmimi për m <sup>2</sup> |
|-----|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------|--------------------------|
| 1.  | Lok.Nr. 13,16 / <b>QT6</b> (ish SPORT- IN)                                                                               | 231.76 m <sup>2</sup> | 18.92€ Neto              |
| 2.  | Lok. Nr . 70 / <b>QT36</b> (ish - Ros Leather)                                                                           | 13.99 m <sup>2</sup>  | 11.87€ Neto              |
| 3   | Lok. Nr . 71 / <b>QT40</b> (ish - Ros Leather )                                                                          | 5.98 m <sup>2</sup>   | 11.87€ Neto              |
| 4.  | <b>Zyrja Nr 116/2 / SU097-1</b> përballë sallës së vogël (DIGJIT – ALB)                                                  | 34.71 m <sup>2</sup>  | 5.99€ Neto               |
| 5.  | <b>Zyre nr. 01 / SU001</b> (Që ndodhet në pjesën A (Llamella A) në nivelin përdhes në pjesën jugore të sallës universal) | 11.96m <sup>2</sup>   | 10.89 € Neto             |
| 6.  | <b>Zyre nr. 06 / SU006</b> (Që ndodhet në pjesën A (Llamella A) në nivelin përdhes në pjesën jugore të sallës universal) | 12.28m <sup>2</sup>   | 10.89 € Neto             |
| 7.  | <b>Zyre nr. 07 / SU007</b> (Që ndodhet në pjesën A (Llamella A) në nivelin përdhes në pjesën jugore të sallës universal) | 12.18 m <sup>2</sup>  | 10.89 € Neto             |
| 8.  | <b>Zyre nr. 08 / SU008</b> (Që ndodhet në pjesën A (Llamella A) në nivelin përdhes në pjesën jugore të sallës universal) | 11.96 m <sup>2</sup>  | 10.89 € Neto             |
|     | <b>DEPOT E SPORTIT</b>                                                                                                   |                       |                          |
| 9.  | Depo nr. <b>SU081</b> (përball trim kabinetit në korridorin e Sallës së Vogël të Sportit DEPO NEN SHKALL)                | 112.5 m <sup>2</sup>  | 3.58 € Neto              |
| 10. | Depo nr. <b>SU076</b> (ish Sigurimit në korridoret e Sallës së Vogël të Sportit)                                         | 27.58 m <sup>2</sup>  | 3.58 € Neto              |
| 11. | Depo nr. 016/138 / <b>SU058</b> (ish spor-in)                                                                            | 34.2 m <sup>2</sup>   | 3.58 € Neto              |

### Vërejtje:

Për hapësirat sportive, mund të aplikojnë vetëm federatat dhe klubet sportive, pasi ato janë të destinuara për veprimtari sportive.

Afati i kontratës:

Një (1) vit nga data e lidhjes së kontratës.

Dokumentet që duhet të dorëzohen:

1. Formulari i aplikimit i cili mund të shkarkohet përmes ueb faqes/emailit zyrtar,
2. Kopje e certifikatës së regjistrimit të biznesit dhe numrit fiskal me të dhëna përkatëse;
3. Kopje e dokumentit të identifikimit të përfaqësuesit ligjor të biznesit;
4. Oferta financiare – çmimi për m<sup>2</sup> (pa TVSH);
5. Vërtetim nga ATK-ja që dëshmon se biznesi është aktiv;
6. Të dhënat e arkës fiskale;
7. Dëshminë e pageses për aplikim në vlerë prej 300 euro e cila paguhet në xhirollogaritë e Pallatit,

Kriteret për përzgjedhjen e ofertuesit më të favorshëm:

1. Çmimi më i lartë se sa çmimi fillestar i shpallur për m<sup>2</sup>;
2. Tarifa e aplikimit është 300,00 €, e cila paguhet në xhirollogari;
3. **17-08-0206-000-000-56 (NLB)**
4. **20-33-0002-180-440-76 (TEB)**
5. **2415-1306-0000-2579 (PriBank)**

Tarifa kompensohet me faturën e parë të qirasë.

- Nëse ofertuesi i përzgjedhur tërhiqet nga kontrata, tarifa nuk i kthehet.
- Ofertuesve të pazgjedhur, tarifa u kthehet.

Ofertat nuk do të merren parasysh në rastet kur:

1. Ofertuesi ka qenë qiramarrës i papërgjegjshëm më parë;
2. Oferta nuk përmban të gjitha dokumentet e kërkuara;
3. Oferta arrin pas datës dhe orës së përcaktuar.

Afati i dorëzimit të ofertave:

Ofertat duhet të dorëzohen në zarf të mbyllur më datë **12.08.2026, në ora 11:30** në Zyrën e Arkivës – N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.

Në pjesën e jashtme të zarfit duhet të shënohet:

- Emri i ofertuesit
- Numri i hapësirës
- E-maili zyrtar
- Numri i telefonit

Hapja e ofertave:

Ofertat do të hapen nga Komisioni për Vlerësim në prani të ofertuesve, 10 minuta pas përfundimit të afatit të dorëzimit – pra më **12.08.2026, deri në ora 11:40,** në zyret e Drejtorisë së N.P.L. Pallati i Rinisë SH.A.

Vizitat në hapësira:

Të gjithë të interesuarit mund t'i vizitojnë hapësirat nga **03.08.2026 deri më 11.08.2026,** çdo ditë pune, nga ora 10:00 – 15:00, duke u lajmëruar te Recepcioni i N.P.L. Pallati i Rinisë SH.A.

Kërkesa / Aplikacioni mund të merret:

- Në e-mail: [contact@pallatirinise.com](mailto:contact@pallatirinise.com)
- Në uebfaqen zyrtare: [www.pallatirinise.com](http://www.pallatirinise.com)
- Fizikisht në Recepcionin e N.P.L. Pallati i Rinisë SH.A.
- 

Për më shumë informata, jeni të mirëpritur të kontaktoni me zyrën përkatëse.